

**Gjykata Themelore Gjakovë- Dega Malishevë, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Nehat Qelaj kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Musa Mazreku dhe Hatixhe Bashota anëtar, në çështjen juridike të paditëses tani propozueses L. N. S.e vajzëris M. nga fshati T. Komuna e Malishevës, të cilën e përfaqëson me autorizim av. F. M. nga M., dhe të paditurit tani propozuesit B. A. S. nga fshati B. Komuna Malishevë, lidhur me zgjidhjen e martesës, në shqyrtimin jo publik të mbajtur me datë 04.09.2018 mori dhe shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I.** Zgjidhet martesë me shkurorëzim me marrëveshje në mes të propozueses L. N. S. e vajzëris M. nga fshati T. Komuna e Malishevës dhe B.A S. nga fshati B. Komuna e Malishevës, martesë kjo e lidhur me datë 07.08.2014 në Zyrën e Gjendjes Civile në B. Komuna e Malishevës e evidentuar sipas numër rendor ... dhe me numër të Referencës .....

**II.** Shpenzimet e procedurës do ti bart se cila palë të vetat.

### **A R S Y E T I M**

Paditësja tani Propozuesja L. S. e vajzëris M. nga fshati T. Komuna Malishevë, me datë 01.08.2017 fillimisht në këtë gjykatë ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës ndaj B. S. duke theksuar ndër tjera se ndërgjyqësit kanë lidhur martesë me datë 07.08.2014 në zyrën e gjendjes civile në B., paditësja me të paditurin nuk kanë bashkëjetuar asnjëherë por vetëm kanë lidhur kurorë, duke i rregulluar dokumentacionin të paditurit i cili ka shkuar në I. sepse paditësja atje jeton me familjen, dhe pasi ja ka rregulluar dokumentacionet menjëherë kanë nisur mosmarrëveshjet mes të dy bashkëshortëve, dhe kështu kjo martesë nuk ka pasur sukses, dhe nuk është arritur qëllimi i martesës, bashkëshortët nuk kanë fëmijë dhe as që pritet të kenë, paditësi me të paditurën i kanë rregulluar raportet familjare ne mes tyre sipas zakoneve dhe traditave dhe nuk kanë asnjë problem mes vete mirëpo kërkojnë ta zgjidhin martesën pasi që i padituri jeton në Itali dhe paditësja nuk komunikon me të. Dhe kërkojnë nga gjykata që të zgjidhë martesën mes tyre.

Seanca për tentim pajtimi nuk u mbajt për arsye se nuk mori pjesë paditësja-propozuesja personalisht, sepse e njëjta sipas të autorizuarit të saj gjendet në I..

Gjykata më pas vazhdoi seancën për shqyrtimin e kësaj çështje në të cilën i autorizuari i paditëses tani propozese L. M. këtu Av. F. M. deklaroi se mbesim pranë padisë për zgjidhje të martesës në mes paditëses dhe të paditurit e lidhur me datë 07.08.2014, pranë zyres së gjendjes civile në B., arsyeja pse kërkohet për zgjidhjen e kësaj martese është shkaku që nuk është arritur qëllimi i martesës, paditësja me të paditurin nuk kanë fëmijë, kështu që mbesim pranë asaj që të prishet kjo martesë.Kërkesa tjera nuk kemi. Ndërsa në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses tani propozueses deklaroi se: pasi që i padituri B. S. pajtohet që të prishet kurora e lidhur me datën 07.08.2014 me paditësen L. S. e lindur M., i propozojmë gjykatës që të miratohet padia, për prishjen e kësaj martese, shpenzimet do ti bartë secili të vetat.

Ndërsa i padituri personalisht B. S. deklaroi se paraprakisht nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë dhe shton se është e vërtetë se me paditësen kemi lidhur martesë me datën 07.08.2014, në B., me të njëjtën i kam rregulluar dokumentacionet në I., me të njëjtën kemi pasur kontakte gjatë rregullimit të dokumenteve dhe ndër kohë ne mes neve kanë lindur mosmarrveshjet të cilat u keqësuan edhe raportet tona e që si pasojë e tyre martesë jone dështoj.Që nga kjo kohë nuk kemi pasur kontakte kështu që unë pajtohem që të zgjidhet kjo martesë për arsyet e lartëcekura, fëmijë nuk kemi pasur dhe as nuk pritet të ketë.

Ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se vazhdoj të mbesë si në deklaratimet në këtë seancë duke i propozuar gjykatës që të zgjidh martesën ne mes meje dhe L., pasi që martesës tonë që në fillim i ka humbur kuptimi i saj, dhe nga ajo kohë nuk kemi pasur kurfar kontakti, dhe as nuk ka mundësi që të rikthehet në martesë, dhe se ne faktikisht edhe përmes familjeve jemi ndarë, shpenzimet do ti bartë secili të vetat.

I autorizuari i paditëses pas deklaratimeve të të paditurit i cili nuk e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë i propozon gjykatës që kjo padi të trajtohet si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës, i padituri nuk e kundërshtoi këtë propozim dhe u pajtua që kjo padi të shëndrrohet në propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës, andaj gjykata konform nenit 68 par.4 të Ligjit mbi familjen në Kosovë (më tej LMFK) konsideroi se bashkëshortët paraqitën propozim të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje.

Gjykata, në procedurën e provave bëri leximin e provave materiale si në vijim: Certifikatën e martesës me nr. rendor ... dhe numër te referencës .....

Pas shqyrtimit të bazueshmërisë së padisë tani propozimit e së bashku me provat mbështetëse dhe atyre që u thanë në seancë të shqyrtimit nga i autorizuari i propozueses dhe i padituri-propozuesi, gjykata konstatoi se propozuesit me datë 07.08.2014 në zyrën e gjendjes civile në B. Komuna në Malishevë kanë lidhur martesë e që kjo dëshmohet nga certifikata e martesës me numër rendor ... me nr. Referencës ..... Propozuesit pasi kanë lidhur martesë nuk kanë bashkëjetuar, mirëpo pasi paditësja-propozuesja të paditurit-propozuesit i kishte rregulluar dukumentacionin për në I. kishin filluar të keqësohen raportet si pasoj e mosmarrëveshjeve mes tyre e si rrjedhojë e të cilave martesë e tyre nuk ka pasur sukses dhe nuk është arritur qëllimi i martesës.

Nga kjo martesë gjykata konstatoi faktin që ndërgjyqësit nuk kanë fëmijë dhe as që pritet të kenë, prandaj bazuar në nenin 68 par.2 dhe nenin 69 par.1 dhe 2 e në lidhje me nenin 84 par.1 të Ligjit për Familjen e Kosovës, vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e kësaj martesë ashtu që vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, për shpenzimet e procedurës, vendosi në bazë të nenin 347 LMFK-se ne lidhje me nenin 450 te LPK-se dhe vendosi qe keto shpenzime ti bartë secila të vetat.

Nga të cekurat më lartë kjo gjykata në bazë të nenit 72 dhe 73 Ligjit mbi Familjen të Kosovës në kompetencë të saj vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i përgjithshëm.  
Divizioni Civil  
C.nr.259/2017, datë 04.09.2018**

**Kryetari i trupit gjyqës  
Gjyqtari, Nehat Qelaj**

---

**Udhëzim juridik:** Meqenëse pas shpalljes së Aktgjykimit, i autorizuari i propozueses dhe propozuesi personalisht kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e ankesës kundër këtij Aktgjykimi, i njëjti është i plotfuqishëm nga data e shpalljes më datë 04.09.2018.